

**STATUTI I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“F.NOVA Z ”**

Ne Gjirokaster, sot me date 14-09-2021, me vullnetin time te lire dhe bazuar ne ligjin 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare , une I nenshkruarI :

- Drini Zervoj i biri i Sulejmanit , i datelindjes 09-04-1979 banues ne Gjirokaster , mbajtes i kartes se identitetit H904090611

Vendosa :

**NENI 1**

Te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “F.NOVA Z” . Shoqeria eshte e formes “ Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar” SH.P.K.

**NENI 2**

Objekti I veprimtarise te shoqerise do te jete :

Agro - turizem. Veprimtari ne fushen bujqesore (mbjellje fidanesh, vreshtari, pentari etj), blektorale (mbareshtim kafshe te imta, lope, shpende, bletari dhe derra etj) per zhvillim Agro-turizmi. Bujtine. Operator turistik. Import te cdo lloj artikulli apo makinerie ne funksion te aktivitetit te me siperm



### **NENI 3**

Afati I shoqerise :

- Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe te paktuar kohore .
- Por ky afat mund te ndryshoje me vullnetin e lire te ortakeve.

### **NENI 4**

Selia e shoqerise :

Gjirokaster, komuna Cepo, fshati Fushe Bardhe, vendi I quajtur LEREZ , parcela 399

### **NENI 5**

Kapitali I shoqerise :

- Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 100 000 leke (njeqin mije leke) .
- Kapitali I shoqerise do te zoterohet :
- Drini Zervoj 100 % te kapitalit ose 1 kuote te barabarte me 100 000 leke
- Shoqeria mund ta zmadhoje ose ta zvogeloje kapitalin e saj .

### **NENI 6**

Pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara nga ortaket jane te transmetueshme nepermjet :

- Nepermjet dhurimit
- Trashegimise
- Shitjes

Ortaket e shoqerise kane te drejten e parablerjes se kuotave te ofruara per shitje .

Çdo mos marreveshje ndermjet ortakeve zgjidhet nepermjet Gjykates .  
Asambleja e ortakeve miraton transferimin e tyre .

### NENI 7

Fitimi I realizuar nga veprimtaria e shoqerise u takon ortakeve te shoqerise ne raport me kontributin e e tyre ne krijimin e shoqerise .

Fitimi I deklaruar ne pasqyrat financiare mund te shperndahet vetem nese shoqeria ka likuide te mjaftueshme qe garantojne shlyerjen e detyrimeve .


Shoqeria mund te kerkoje kthimin e dividenteve te shperndare tek ortakët e saj ne rast se shperndarja eshte bere ne kundërshtim me kete dispozite .

### NENI 8

Administrimi :

- Organi me I larte I shoqerise eshte asambleja e pergjitheshme e ortakeve .
- Asambleja e ortakeve thirret nga ortakët ose administrator I shoqerise .
- Njoftimi per mbledhjen e asamlese se ortakeve behet me shkrese zyrtare dhe u dergohet ortakeve te pakten 10 dite perpara dates se mbledhjes .
- Administratori drejton mbledhjen e asamlese se ortakeve .
- Ortakët mund te perfaqesohet gjate mungeses se tyre nga nje ortak tjetër ose nje person I autorizuar .
- Autorizimi eshte I vlefshem vetem per nje mbledhje

Asambleja e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve si me poshte :





- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise .
- Ndryshimet e statutit te shoqerise I cili behet me  $3/4$  e kuotave te kapitalit te shoqerise .
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorit .
- Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel .
- Pregatitjes se pasqyrave financiare .
- Futjen e ortakeve te rinj ne shoqeri .
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
- Zmadhimin ose zvogelimin e aktivitetit te shoqerise .
- Riorganizimin , bashkimin , ndarjen apo prishjen e shoqerise .
- Krijimin ose mbylljen e filialeve te tjera te shoqerise .
- Vendimet e mbledhjes se asamblese se ortakeve pasqyrohen ne nje rregjister te vecante

## NENI 9

Administratori :

- Administrator I shoqerise do te jete Drini Zervoj
- .
- Afati administratorit do te jete 5 (pese ) vjet .
- Afati I administratorit mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve .

## NENI 10

Administratori I shoqerise ka kopetence dhe detyrohet te kryeje veprimet e percaktuara kryesisht ne nenin 95 te ligjit 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" .

Administrator mund te shkarkohet me vendim te asamblese se ortakeve



Administratoret permbushin detyrimet qe u lindin nga neni 98 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

### **NENI 11**

Per arritjen e qellimeve te veta shoqeria mund te punesoje punonjes te tjere te ndryshem , duke respektuar legjislacionin ne fuqi .

### **NENI 12**

Ortaku mund te perjashtohet nga shoqeria me vendim te gjykates per arsyet e permendura ne nenin 102 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

Shoqeria rezervon te drejten per te kerkuar shperblimin e demit te ardhuar nga veprimet e ortakut qe cuan ne perjashtimin e tij .

### **NENI 13**

Shoqeria priset :

- Ne perfundim te afatit .
- Eshte vendosur me unanimitet nga asambleja e pergjitheshme e ortakeve
- Me hapjen e procedurave te likujdimit .
- Me vendim te Gjykates



## NENI 14

Fitimi qe do te rezultoje nga veprimtaria e shoqerise I taPkon ortakeve te saj . shoqeria nuk pergjigjet per humbjen e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise . Mosmarreshjet qe mund te lindin mes paleve brenda dhe jashte shoqerise , me persona fizike e juridike zgjidhen nga Gjykata Kopetente Shqiptare

ORTAKU THEMELUES

DRINI ZERVOJ

DRINI ZERVOJ

